

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

PROGRAMI GJUHË SHQIPE



PUNIM DIPLOME

ANGLICIZMAT NË GJUHËN SHQIPE

MENTORI:

Prof. asoc. dr. Fridrik Dulaj

STUDENTI:

Arbër Hilaj

Gjakovë, 2019

PËRMBATJA

Falënderim.....	2
Abstrakti.....	3
Hyrja.....	4
Një historik i shkurtër i gjuhës shqipe.....	5-6
Një historik i shkurtër i gjuhës angleze.....	5-8
Rëndësia e gjuhës angleze.....	9-10
Anglicizmat në gjuhën shqipe.....	11-12
Anglicizmat në revista dhe gazeta.....	13-14
Anglicizmat në teknologji dhe rrjete sociale.....	15-18
Anglicizmat në portale.....	19-20
Anglicizmat në të folurit e përditshëm.....	21-22
Përfundimi.....	23
Literatura.....	24

FALËNDERIM

Për të arritur këtu ku jam duhej shumë mund dhe sakrificë po ashtu edhe mbështetje të cilën e gjeta më së shumti tek familja ime të cilës i jam mirënjohës dhe falënderues pafundësisht për çdo gjë që bën për mua.

Dashuri dhe respekt të pafund kam edhe për shoqërinë time e cila ishte krah meje për të më mbështetur në çdo hap dhe duke më ndihmuar për të arritur këtu ku jam.

Falënderim i veçantë është për Prof. Asoc. Dr. Fridrik Dulaj i cili më ndihmoi në përzgjedhjen e temës dhe më qëndroi pranë në çdo hap rreth zhvillimit të saj me sugjerimet e tij.

Në fund, por jo të fundit meritojnë falënderime dhe respekt i gjithë stafi i Universitetit “Fehmi Agani” të cilët vendosen bazat dhe më ngritën këtu ku jam.

Falënderues për zemërsisht.

ABSTRAKTI

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe përbën një trung të vetëm. Gjurmët e para të kësaj gjuhe i gjejmë tek ‘*Formula e pagëzimit*’ e Pal Engjullit të vitit 1462, për të vazhduar më pas me librin e parë ‘*Meshari*’ i Gjon Buzukut i vitit 1555 edhe pse dokumentet e dëshmojnë këtë vjetërsi mendohet se kjo gjuhë është folur dhe shkruar edhe më herët, shqipja ka dy dialekte kryesore toskërishten dhe gegërishten si dhe variantin e gjuhës standarde.

Edhe pse e pasur nga fjalët tipike shqipe të dallueshme në këtë gjuhë janë edhe fjalët e prejardhura kryesisht nga sundimet e shumta që ka pasur ky vend, pastaj nga fqinjësia e më pak të ndikuara nga gjuhët të ashtuquajtura ndërkombëtare.

Më së shumti kanë fjalë të trashëguara nga leksiku turk për arsye të sundimit shekullor në këtë rajon, më pas vijnë fjalët e prejardhura nga leksiku i gjuhëve të ashtuquajtura ish-jugosllave për arsye kryesisht të sundimit e më pak të fqinjësisë, ka fjalë dhe me prejardhje latine, greke dhe ato nga kultura arabe mirëpo kohëve të fundit shihet tendenca e futjes se fjalëve nga gjuhët ndërkombëtare kryesisht në fushën e politikës dhe teknologjisë në gjuhën shqipe ku si gjuhë ndërkombëtare është anglishtja për të cilën do të flasim në vazhdim.

Në këtë temë do të shqyrtojmë në mënyrë sa më të saktë fjalët e huazura nga gjuha angleze, të cilat duhen të zëvendësohen me fjalët gjegjëse shqipe.

Poashtu këtu kemi paraqitur dhe një historik të shkurtër të zhvillimit të gjuhës shqipe, si dhe asaj angleze, duke kaluar nëpër etapa dhe zhvillim kronologjik.

Poashtu theks të veçantë i kemi ushtuar fjalëve angleze të cilat kanë gjegjësen në shqipe.

Fjalët kyçe: *gjuha shqipe, anglicizmat, televizori, kompjuteri, gazetat, revistat etj.*

HYRJA

Në këtë temë do të flasim rreth futjes së fjalëve të panevojshme në shumicën e rasteve të gjuhës angleze në gjuhën shqipe, në fusha të ndryshme kryesisht politike dhe teknologjike, si dhe përdorimin e tyre që nga rrjetet sociale dhe mjetet e informimit e deri tek të folurit e përditshëm nga folësit e moshave të ndryshme.

Qëllimi kryesor i këtij punimi diplome është që të theksojë dhe të vë në pah fjalët angleze (anglicizmat), të cilat përdoren më së shumti në gjuhën shqipe e që në të shumtën e rasteve janë të panevojshme. Gjuhët, si kulturat, rrallë i mjaftojnë vetvetes. Nevoja për marrëdhënie i sjell folësit një gjuhë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me ata të gjuhës tjetër nevojën për huazim të fjalëve të njëra-tjetrës. Kështu ka ndodhur edhe me gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Në fakt, gjuha angleze është një trend botëror, gjuhë zyrtare thuajse në të gjitha shtetet e botës, prandaj edhe fjalët e saj janë joshëse për të gjitha gjuhët tjera (përfshirë këtu edhe gjuhën shqipe).

Trajtimi teorik i punimit bazohet kryesisht në literaturën ekzistuese mbi tematikën në fjalë në gjuhën amtare dhe në gjuhën angleze, me synimin kryesor përshkrimin sa më të thukët të nocionit *anglicizëm* dhe përdorimit të tyre në në gjuhën shqipe.

Metoda kryesore që është përdorur në këtë punim diplome është metoda e intervistimit. Janë intervistuar njerëz të moshave të ndryshme me qëllim që të shihet qartë ndikimi i anglicizmave në moshë të ndryshme. Pastaj kemi edhe metodën e hulumtimit në literaturë të ndryshme, si dhe metodën e shqyrtimit të ideve.

NJË HISTORIK I SHKURTËR I GJUHËS SHQIPE

Gjuha shqipe është degë e veçantë e familjes indo-evropiane të folur nga më shumë se 6 milionë njerëz, kryesisht në Shqipëri, Kosovë dhe Republikën e Maqedonisë, por edhe në zona të tjera të Evropës Jugore ku ka një popullsi shqiptare, duke përfshirë Malin e Zi dhe Luginën e Preshevës. Është gjuha zyrtare e Shqipërisë dhe Kosovës. Komunitetet shekullore që flasin dialektet shqiptare gjenden të shpërndara edhe në Kroaci (Arbëreshët në Zarë), Greqi (Arbëreshët në Çamëri), në disa komunitete në rajonet e Maqedonisë Perëndimore dhe Trakes Perëndimore, në Itali (Arbëreshët në Italinë Jugore, Sicili dhe Kalabri) si dhe në Rumani dhe Ukrainë. Ekziston po ashtu edhe një diasporë e madhe shqiptare në vendet si Gjermani, Zvicër, Austri, Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj. Ishte merita e dijetarit të njohur gjerman Franz Bopp, që vërtetoi me metoda shkencore përkatësinë e gjuhës shqipe në familjen gjuhësore indoevropiane. Në ndarjen e gjuhëve indoevropiane në dy grupe: në gjuhë lindore ose satem dhe në gjuhë perëndimore ose kentum, shqipja shkon me gjuhët lindore (satem), bashkë me gjuhët indo-iranike, gjuhët balto-sllave dhe armenishten.

“Krahasuar me gjuhët e tjera kombëtare të Evropës, shqipja nuk gëzon traditë letrare të gjatë. Në fakt, shqipja është gjuha kombëtare e fundit në Evropë që është dokumentuar. Kjo rrethanë është sidomos për të ardhur keq jo vetëm nga pikëpamja letrare (ndonëse dihet që kemi disa dokumente të shkruara në latinishte për shqiptarët), por edhe nga ajo gjuhësore, d.m.th. nuk ka gjurmë të rëndësishme të gjuhës shqipe që të datojnë para shekullit të pesëmbëdhjetë. Fillimet e letërsisë shqiptare, ose për të folur më saktë për këtë periudhë - të shkrimit shqip, janë të rralla dhe disi të errëta. Shqipja është një nga gjuhët e lashta të Ballkanit, por e dokumentuar me shkrim mjaft vonë, në shekullin XV”.¹

“Dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe, është ai që quhet “*Formula e pagëzimit*”, e vitit 1462. *Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit* (Unë të pagëzoj në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit të Shenjtë). Autori i kësaj formule ishte Pal Engjëlli, argjipeshkëv i Durrësit dhe mik i ngushtë e bashkëpunëtor i Skënderbeut. Kjo formulë mban datën 8 nëntor 1462 dhe është shkruar që fëmijët të pagëzoheshin më lehtë. Teksti u zbulua në Bibliotekën Laurentiane në Firence nga dijetari rumun Nicolae Iorga.

¹<https://www.kohajone.com/2016/07/30/gjuha-shqipe-dhe-historiku-i-saj/>

Dokument tjetër që dëshmon lashtësinë e gjuhës shqipe është “*Ungjilli i Pashkëve*” i quajtur ndryshe edhe si Perikopeja, shkrim me pesëmbëdhjetë rreshta në mes në të një përkthimi greqisht. Edhe pse autori i tekstit nuk dihet, teksti është shkruar në dialektin toskë.

Një tekst tjetër shumë i rëndësishëm që dëshmon lashtësinë e gjuhës shqipe është fjalori shqip i Arnold fon Harfit. Arnold fon Harfit ishte një kalorës gjerman, udhëtar dhe shkrimtar, i cili gjatë udhëtimit për në Tokën e Shenjtë kalon nëpër disa vende, ndër to edhe në tokat shqipe si shembujt më të mirë të kësaj gjinie, aq shumë të përhapur në fund të periudhës së mesjetës. Gjatë këtij udhëtimit ai mbajti shënime për gjërat elementare.

Vepra e njohur përgjithësisht me emrin Meshari nga Gjon Buzuku është libri i parë në gjuhën shqipe e njëherazi një nga frytet më interesante në historinë e letërsisë shqiptare, të paktën nga pikëpamja gjuhësore e kulturore. Për shkak se ballina dhe gjashtëmbëdhjetë faqet e para të kopjes së vetme të njohur të kësaj vepre historike mungojnë, për titullin origjinal dhe vendin e botimit vetëm mund të hamendësohet. Është vërtetë një mrekulli që ky monument i madh i letrave shqiptare ka ardhur deri në ditët tona. Për autorin e Mesharit shqiptar dihet pak. Nga tiparet dialektore të gegërishtes veriperëndimore të tekstit, mund të gjykohet se familja e Gjon Buzukut duhet të jetë diku nga fshatrat e bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, ndoshta afër Shestanit, tani në territorin e Malit të Zi. Ato të dhëna të pakta që kemi për Buzukun, vijnë nga pasthënia e Mesharit, të cilën Buzuku e shkroi me dorën e vet në gjuhën shqipe, pa e ditur ç’përmasa historike do të merrte kjo punë e tij’’².

‘‘Për shqiptarët themi se i përkasin një bashkësie gjuhësore, sepse ata të gjithë komunikojnë midis tyre me anë të gjuhës shqipe. Kjo është gjëja themelore e përbashkët që i bashkon ata; tej kësaj nisin dallimet: Shqipatër jetojnë të ndarë në krahina, qytete, fshatra, madje edhe në shtete të ndryshme; atau përkasin shtresave të ndryshme shoqërore fashatë, puntorë, intelektualë, të pasur, të mesëm, të varfer, janë moshash e seksesh të ndryshme.

Dallime e më sipërme doemos që shihen edhe në gjuhë. Ato janë territoriale, sociale e profesionale.

Cilido prej nesh është i vetëdijshëm për këto dallime’’³.

² Hamiti, Sabri, “Letërsia e vjetër shqipe I”, Albas, Tiranë, 2004, fq.105

³ Memushaj, Rami, “*Shqipja standarde*”, Toena, Tiranë, 2004, fq.45

NJË HISTORIK I SHKURTËR I GJUHËS ANGLEZE

Anglishtja si gjuhë bën pjese po ashtu në grupin e gjuhëve indoevropiane përkatësisht në degën e gjuhëve gjermanike, e njohur në gjithë botën si gjuhë ndërkombëtare, edhe pse rrjedh nga gjuha e vjetër e anglo-saksonëve që erdhën në gadishullin Britanik në kohën e mesjetës së hershme tek kjo gjuhë vërehet qartë edhe ndikimi në fjalë nga gjuhët frënge dhe latine.

Si gjuhë e folur ka një shtrije të madhe kryesisht flitet në Britaninë e Madhe, Shtetet e Bashkuara, Kanada, Irlandë, Australi, Zelandë e Re dhe në një numër vendesh tjera.

Përdoret po ashtu si gjuhë zyrtare dhe gjuhë e dytë në shumë vende të botës, ajo njihet edhe si gjuhë e arsimit, shkencës, tregtisë dhe diplomacisë.

‘Më shumë njerëz në botë përpiqen të mësojnë gjuhën angleze se cilëndo gjuhë tjetër’.

Anglishtja është gjuha e bisedimeve politike, biznesit ndërkombëtar, komunikacionit ajror, shkencës dhe mjekësisë botërore. Mirëpo, nga erdhi anglishtja dhe si u bë kaq popullore?

Materiali në vijim i hedh një vështrim historisë së gjuhës angleze që fillon rreth 5 mijë vjet më parë, diku pranë brigjeve veriore të Detit të Zi në Evropën juglindore. Ekspertët thonë se banorët e brigjeve të Detit të Zi flisnin një gjuhë që sot quhet proto-indo-evropianishte. Ajo gjuhë nuk flitet më dhe hulumtuesit nuk e dinë se si tingëllonte. Por, familja proto-indo-evropiane e gjuhëve besohet të jetë paraardhësja e shumicës së gjuhëve evropiane, përfshirë greqishten e vjetër, gjermanishten e lashtë, latinishten dhe ilirishten. Këto gjuhë u zhdukën si gjuhë të folura, por lanë pas bijat e tyre. Latinishtja evoluoi në spanjishte, frëngjishte dhe italishte. Gjermanishtja e lashtë u shndërrua në holandishte, danishte, gjermanishte, norvegjishte, suedishte dhe në njërën nga gjuhët që më vonë mori trajtën e anglishtes së sotme. Gjuha angleze është rrjedhojë e dyndjeve të Britanisë nga popuj të ndryshëm. Dyndjet e para u ndërmorën rreth 1 mijë e 500 vjet më parë nga anglët, një fis gjerman i cili kaloi kanalën e Lë Manshit, që ndan Evropën kontinentale nga ishulli britanik. Më vonë edhe dy fise të tjera të tjera, saksonët dhe jutët, invaduan Britaninë. Keltët, që ishin populli i lashtë i Britanisë, iu kundërvunë me luftë dyndjeve të fiseve gjermane, por shumica e vendasve u vranë ose u skllavëruan dhe disa syresh u larguan drejt pjesëve të tjera të ishullit. Me kalimin e kohës, banorët e rinj, anglët, saksonët dhe jutët, përzien gjuhët e tyre të ndryshme, duke krijuar gjuhën anglosaksone apo anglishten e vjetër. Anglishtja e vjetër është shumë e vështirë për t’u kuptuar dhe vetëm disa ekspertë mund ta lexojnë këtë formë të gjuhës angleze.

Në anglishten e vjetër u shkrua poema epike e Beulfrit, e cila i kushtohet një mbreti popullor. Ekspertët thonë se ajo është e para poema në gjuhën angleze dhe se u shkrua mbi 1 mijë vjet më parë nga një autor i panjohur. Rreth 1 mijë e 100 vjet më parë, Britania u pushtua sërish, kësaj radhe nga një popull luftarak të quajtur vikingë. Këta vinin nga Danimarka, Norvegjia dhe vendet e tjera nordike me synimin për të rrëmbyer mallra dhe skllavër. Por shumë vikingë ngelën përherë në Britani dhe ndikuan edhe në gjuhën angleze. Shumë fjalë të rëndësishme që përdoren sot në anglishte vijnë nga gjuhët të cilat fliteshin në vendet nordike. Më

pas, në vitin 1066, Britaninë e pushtuan normandët, një popull frëngjishtfolës nga krahina e Normandisë, në veri të Francës. Ata u bënë sundimtarët e rinj të Britanisë dhe për shekuj me radhë folën vetëm frëngjisht. Ajo ishte gjuha e njerëzve të arsimuar, ndërsa anglishtja e vjetër mbetej gjuha e njerëzve të thjeshtë në Britani. Anglishtja e vjetër huazoi shumë fjalë nga frëngjishtja normane, sidomos në drejtësi dhe administratën shtetërore. Shumica e fjalëve angleze që përdoren sot në këto fusha vijnë nga frëngjishtja, si p.sh. fjalët “parliament” dhe “justice”, që domethënë drejtësi. Frëngjishtja që përdorën sundimtarët normanë ndryshoi mënyrën sesi flitej anglishtja 800 vjet më parë dhe populli filloi të fliste një gjuhë që ekspertët e quajnë anglishte e mesme. Me kalimin e kohës, as pushtetarët nuk flisnin më frëngjisht, por flisnin një gjuhë të përzier të anglishtes së mesme me frëngjishten. Anglishtja e mesme tingëllon si anglishtja moderne, por është akoma e vështirë për t’u kuptuar. Një nga veprat më të famshme në këtë formë të gjuhës angleze është poema e Xhefri Shoserit, “Tregime nga Kanterbëri”, shkruar mbi 600 vjet më parë. Poema flet për vizitorët e ndryshëm në qytetin e Kanterbërit dhe ekspertët thonë se pasqyron qartë njerëzit të asaj kohe. Ekspertët gjithashtu cilësojnë Xhefri Shoserin si autorin e parë të rëndësishëm që përdori gjuhën angleze në shkrimet e tij. Historia e gjuhës angleze vazhdon me shndërrimin e anglishtes së mesme në anglishten moderne që flitet”⁴

⁴<https://www.zeriamerikes.com/a/alb-historia-gjuha-angleze-113869869/457071.html>

RËNDESIDIA E GJUHËS ANGLEZE

Dihet se gjuha është burimi primar i komunikimit midis njerëzve dhe thuhet se “*po mësove një gjuhë mësove një popull*”. Momentalisht gjuha angleze është gjuhë primare, jo vetëm në Britaninë e Madhe, por edhe në shumë vende të tjera ajo cilësohet si gjuhë e Hollivudit, gjuhë e bankave ndërkombëtare dhe e biznesit dhe duke u parë nga ky aspekt si e tillë ajo duhet të mësohet.

Duke qenë si gjuhë ndërkombëtare ajo shërben edhe si urë lidhëse midis dy individëve të gjuhëve dhe kulturave të ndryshme p.sh një shqiptar dhe një gjerman e ka me të lehtë komunikimin në qoftë se përdorin anglishten si gjuhë të tretë.

Rëndësi të madhe i kushtojnë mësimin të gjuhës angleze edhe nëpër shkolla për arsye se kjo gjuhë konsiderohet si gjuhë e shkencës madje një numër i madh veprash kryesisht shkencore dhe teknologjike janë shkruar në gjuhën angleze për të qenë të qarta për studentët ndërkombëtarë, mësimi i gjuhës angleze në shumë shkolla është bërë esencial që nga shkolla fillore.

Nëse je folës i kësaj gjuhe e ke më të lehtë qasjen në rrjete sociale si dhe në ëëbsit-e të ndryshme pasi që shumica e tyre kanë për bazë gjuhën angleze, shumica e gazetave dhe revistave në mbarë botën janë të shkruara në gjuhën angleze për ta pasur me të lehtë komunikimin me të gjithë njerëzit pra, edhe në shtyp dhe në internet kërkohet njohja e kësaj gjuhe.

Për sa i përket mësimin të kësaj gjuhe, është shumë i lehtë pasi që cilësohet si gjuha më e lehtë për t’u mësuar pasi që ka burime të mjaftueshme, jo vetëm përmes librave kryesisht gramatikor, por edhe përmes televizorit dhe emisioneve me tjera në një gjuhë të caktuar.

Me një komunikim dhe kuptim të mirë të anglishtes ti mund ta udhëtosh botën të njohësh dhe të takosh njerëz dhe kultura të ndryshme, po ashtu mund ti sigurosh vetës një punë të mirë në një kompani prestigjioze e cila konkurren në nivelin ndërkombëtar vetëm pasi që di të flasësh dhe të shkruash mirë anglisht, sepse sipas tyre po dite gjuhën je i miredukuar.

Gjuha angleze ka rëndësi edhe në fushën e artit pasi që shumica e filmave dhe muzikës bëhen në këtë gjuhë dhe për t’i kuptuar këto duhet ta mësosh gjuhën.

“Ja disa fakte se pse anglishtja është gjuha më e madhe në botë:

1. është gjuhë zyrtare në 79 vende dhe territore.
2. Sipas fjalorit të Oxfordit ka rreth 615.000 fjalë.
3. Rreth 1.5 miliardë njerëz e flasin këtë gjuhë këtu përfshihen edhe folësit jo amtare.
4. Është dominante rreth 80% është e shkruar në këtë gjuhë.”⁵

Gjuha angleze është një ndër gjuhët më të përhapura në rruzullin tokësor dhe si pasojë e përhapjes së saj ajo jep mundësi edhe për huazime.

Mësimi i gjuhës angleze hap dyert në shumë vende të botës qoftë edhe nëse shkoni në vizita turistike anë e mbanë botës.

⁵https://sq.wikipedia.org/wiki/Historia_e_gjuhes_angleze

Duke qenë se është cilësuar edhe si gjuhë e shumë veprave të shkruara në letërsinë botërore si dhe atyre shkencore njohja e kësaj gjuhe na mundëson t'i kuptojmë ato. Njohja e gjuhës angleze ka rëndësi shumë të madhe në çdo aspekt.

ANGLICIZMAT NË GJUHËN SHQIPE

Me **anglicizma** kuptojmë futjen e fjalëve angleze në përdorim në gjuhën shqipe ku bëhet edhe mosrespektimi i normës standarde.

Shkeljet e gjuhës standarde shqipe sot janë dy llojesh :

1. Mosrespektimi i normave gjuhësore në rrafshet gramatikore – morfologjike madje edhe sintaksore, por sidomos në rrafshin leksikor, veçanërisht në gjuhën e folur, por edhe në gjuhën e shkruar.

2. Përdorimi i fjalëve me prejardhje të gjuhëve të huaja, sidomos të anglishtes.

Anglicizmat në gjuhën shqipe kanë hyrë shumë vonë kryesisht në periudhën e pasluftës në Kosovë si rezultat i ardhjes së organizatave të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare pastaj kemi ndryshimin e sistemit shoqëror ku si pasojë nuk kanë pasur mundësi që t'i kontrollojnë futjen e fjalëve të huaja të cilat kishin ardhur furishëm në vend, dhe nuk janë kontrolluar nga institucionet përkatëse dhe tani më janë bërë pjesë e përditshmërisë qofshin ato të nevojshme, ose të panevojshme pasi që disa prej tyre konsiderohen të nevojshme për arsye të mos pasurit fjalë gjegjëse në gjuhën shqipe.

Të gjitha këto fjalë përbejnë një devijim nga norma e gjuhës standarde prandaj duhet që ne të bëjmë zëvendësimin e këtyre fjalëve me fjalët përkatëse shqipe, pra me një fjalë ta qërojmë gjuhën nga këto huazime.

Duhet të fillojmë që nga institucionet politike e shkollore të cilat i përdorin në masë të madhe për t'u treguar sa më të 'mençur' për të vazhduar më pas tek mjetet e komunikimit si revistat, gazetat dhe portalet vazhdojmë më pas me rrjetet sociale dhe të folurit e përditshëm. Depërtimi i fjalëve angleze ka përfshirë gjuhën shqipe pasi që duket se janë hequr të gjitha pengesat që ndalin huazimin e fjalëve të huaja pasi që askush nuk merret me këtë çështje në përjashtim të disa individëve dhe ndonjë shkrimi aty këtu.

Puna institucionale do të ishte gjithmonë zgjidhje më e mirë, si në shumë fusha të tjera, edhe në këtë fushë veprimi. Për të bërë këtë punë kërkohet kohë e konsiderueshme dhe punë intensive dhe e vazhdueshme. Përveç kësaj kërkohet një përvojë e mirë se si është vepruar me huazimet në të kaluarën, si brenda gjuhës sonë ashtu edhe të gjuhëve të tjera. Por, lipset edhe dije e mjaftueshme dhe përgjegjshmëri e madhe në këtë punë shumë të ndjeshme. E kjo, si duket, na mungon dhe nuk jemi duke vepruar në mënyrë adekuate krahas problemit me të cilin ballafaqohemi.

Huazimet nga gjuha angleze janë bërë për të emërtuar kryesisht emërtime teknologjike, veprime në sporte të ndryshme pastaj shprehje ekonomike dhe politike etj.

Duke u bazuar në kategorinë gramatikore shqipja nga anglishtja ka marrë më së shumti nga emri p.sh *obligim (detyrim)*, *atak (sulm)*, *event (shfaqje)*, *intervenim (ndërrhyrje)*, *asociacon (shoqatë)*, *lider (udhëheqës)*, *kompetencë (përgjegjësi)*, *implementim (zbatim)*, *koordinim (bashkërendim)*,

departament (njësi), aprovim (miratim), progres (përmirësim), barrierë (pengesë), staf (ekipi), resurs (burim), akceptim (pranim), e shumë e shumë të tjera.

Dihet se anglishtja është gjuha më e folur në mbarë botën dhe jep huazime për gati secilën gjuhë tjetër dhe si pasojë e kësaj ndikon edhe në shtrembërimin e asaj gjuhe si në aspektin morfologjik, në aspektin sintaksor, ashtu edhe në leksik. Prandaj, është e nevojshme të mbrohet gjuha.

“ Pasurimi i gjuhës është proces ligjësor objektiv, në të cilin marrin pjesë dhe veprojnë çdo ditë masat punonjëse, puntorët dhe fshatarët e thjeshtë, teknikët specialistët e fushave të ndryshme të shkencës dhe të prodhimit, arsimtarët, shkrimtarët, artistët, ushtarët punonjësit e fushës politiko-shoqërore etj”⁶.

“Për të mbajtur një qëndrim ndaj fjalëve me burim të huaj kërkohet në rradhë të parë njohje e mirë e shtresëzimit të tyre, e vendin që ato kanë zënë në gjuhë, e vlerave kuptimore dhe stilistike që kanë pasur në gjuhë prej nga janë marrë dhe atyre kuptimeve të rej që mund të kenë fituar pasi janë bërë pronë e shqipes”⁷.

Duhet të kemi pasrësh që egzistojnë edhe fjalë të cilat nuk e kanë gjegjesën në shqip prandaj ato cilësohen si ndërkombëtare. “Ku si fjalë ndërkombëtare vështrohen ato fjalë që përdoren në shumicën e gjuhëve të botës (veqanërisht në gjuhët indoevropiane)”⁸

⁶ Shkuraj, Gjovalin, ‘Kultura e gjuhës’, SHBLU, Tiranë, 2006, fq.165

⁷ Shkuraj, Gjovalin, po aty, fq.177

⁸ Shkuraj, Gjovalin, po at, fq.178

ANGLICIZMAT NË REVISTA DHE GAZETA

Revistat dhe gazetat shërbejnë si mjete komunikimi në formën e shkruar, duke e bërë kështu bartjen e mesazhit tek lexuesi. Kohët e fundit në vendin tonë shihet tendenca e zhdukjes së tyre për shkak të digjitalizimit të tyre d.m.th të formës së shkruar në internet.

Në vendin tonë edhe pse të pakta në numër gazetat dhe revistat sot lexohen më së shumti nga mosha e vjetër mirëpo në disa raste ata hasin në pengesa gjatë leximit të tyre për shkak të futjes së një numri të madh të fjalëve të gjuhëve të huaja kryesisht angleze në gjuhën shqipe.

Disa nga gazetat e njohura janë:- “Koha Ditore”, ”Bota Sot”.Zëri”etj. ku disa nga këto mund t’i lexoni edhe në mënyrë online.

Disa nga revistat më të njohura janë: “Kosovarja”.”Living”dhe revistat shkollore si “Pionieri”, ”Mollëkuqja” etj. shumica e revistave kanë karakter kulturor.

Në këtë pjesë do t’i cekim disa nga fjalët angleze të cilat janë të përdorura në revistat dhe gazetat tona të cilat i kam vërejtur gjatë leximit të tyre, dhe sipas mendimit tonë janë të panevojshme dhe duhet të zëvendësohen me fjalët përkatëse shqipe.

Fjalët që janë evidentuar gjatë leximit të gazetës “Zëri” të datës 22.02.2019 dhe janë të përdorur në më shumë se një tekst të shkruar, janë:

ANGLISHT	HUAZIM	SHQIP
Abuse	Abuzim	Shpërdorim
Apply	Aplikoj	Zbatoj
Agent	Agjendë	Rend i ditës
Address	Adresoj	Shqyrtoj
Afirmation	Afirmoj	Pohoj
Apel	Apeloj	Bëj thirrje
Brutal	Brutal	I vrazhdë
Correct	Korrektoj	Korrigjoj
Confidence	Konfidencë	Besim
Consensus	Konsensus	Pëlqej

--	--	--

ANGLISHT	HUAZIM	SHQIP
Dedication	Dedikim	Kushtim
Definition	Definicion	Përkufizim
Determination	Determinoj	Përcaktoj
Experience	Eksperiencë	Përvojë
Event	Event	Ngjarje
False	Fallo	Gënjeshër
Impletation	Inplementim	Zbatim
Independent	Indipendent	I pavarur
Ignorance	Injoruj	Padituri
Influence	Influencë	Ndikim
Peform	Performoj	Shfaq
Perofmance	Performancë	Shfaqje
Principle	Princip	Parim
Leadership	Lidership	Udhëheqje
Quality	Kualitet	Cilësi
Quantity	Kuantitet	Sasi
Observation	Observim	Vrojtim
Support	Suport	Mbështetje
Treatment	Tetman	Trajtim
Union	Union	Bashkim

ANGLICIZMAT NË TEKNOLOGJI DHE RRJETE SOCIALE

Rrjetet sociale janë një tendencë e përhapur në të gjithë botën nga të gjitha moshat. Edhe në vendin tonë kjo tendencë është shumë e përhapur. Faqet e rrjeteve sociale janë komunitete

virtuale pasi mundësojnë qasje në kohë reale, sinkronizim të komunikimit, mundësi të postimit dhe ndarjes së fotove, videove, punës origjinale dhe kreative. Këto faqe janë shumë tërheqëse dhe joshëse për fëmijë dhe adoleshentë. Këto faqe ofrojnë mundësi të shumta për aktivitetet argëtuese që adoleshentët i dinë dhe i dëshirojnë. Disa nga rrjetet sociale më të frekuentuara nga të rinjtë janë: Facebook, Instagram, Tëitter, ehatsApp, Viber, Snapchat etj.

Anglicizmat në Facebook. Anglicizmat kanë përdorim shumë të gjerë në facebook. Kjo ndodh sepse facebook-u është rrjeti më i pordorur social në të gjithë botën. Facebook është themeluar në mars të vitit 2004, nga Mark Zukemberg, fillimisht si rrjet privat mes miqsh, e pastaj mori hovin botëror. Përdorimi i tyre vërehet shumë gjatë bisedave të ndryshme në Messenger, apo komenteve në foto të ndryshme.

ANGLISHT	HUAZIM	SHQIP
Friends	Friends	Miqësi
Like	Like	Pëlqej
Live	Live	Drejtëpërdrejtë
Support	Suportoj	Mbështes
Smile	Smile	Buzëqesh
Search	Search	Kerkoj
Reply	Replay	Kthej
Share	Share	Shpërndaj
Views	Views	Shikime

Anglicizmat në Instagram. Ashtu si facebook-u edhe instagrami është rrjet social mjaft i përdorur nga njerëz të moshave dhe gjinive të ndryshme. Ai shërben edhe si urë lidhëse midis individëve përmes postimeve, pëlqimeve dhe komenteve të ndryshme që ata iu japin njëri tjetrit. Ajo që bie më së shumti në sy është përdorimi i anglicizmave.

ANGLISHT	HUAZIM	SHQIP
Followers	Followers	Ndjekësa
Following	Following	Ndjekës
Mute	Mute	Zërim
Like	Like	Pëlqim
Replay	Replay	Përsëris
Ok	Ok	Në rregull
Copy	Copy	Koje
Post	Post	Shfaq
Mashup	Mashup	Përzierje

Anglicizmat në Snapchat. Snapchati është poashtu një rrjet social i cili ka fituar përhapje të madhe këto vitet e fundit ku përveç shtimit të shoqërisë me pëlqimin tënd ajo që është karakteristikë e saj është se ajo se çfarë vendos tii të shfaqësh brenda afatit prej 24 orësh ajo zhduket edhe në këtë rrjet social bie në sy përdorimi i anglicizmave, apo fjalëve angleze.

ANGLISHT	HUAZIM	SHQIP
Chat	Chat	Bisede
Discover	Discover	Zbulim

Add	Add	Shto
Accept	Accept	Prano
Friends	Friends	Shoqëri
Map	Map	Hartë
Opened	Opened	Hapur

Anglicizmat nëWhatsApp dhe Viber. Që të dyja këto rrjete sociale janë të përdorura më së shumti për arsye që ato ofrojnë një komunikim, ose bashkëbisedim midis personave të caktuar pa pagesë dhe me kamerë, mirëpo si çdo rrjet tjetër social edhe këtu vërehet tendenca e përdorimit tëanglicizmave të cilat do ti paraqesim më poshtë.

ANGLISHT	HUAZIM	SHQIP
Contact	Contact	Lidhje
Person	Person	Njeri
Seen	Seen	Shikoj
Calls	Calls	Thirrje
New	New	I ri
Invite	Invite	Ftoj
Conect	Conect	Lidhje
Sticker	Sticker	Figura
More	More	Më shumë

Anglicizmat në teknologji. Siç u shprehëm edhe më lart gjuha angleze cilësohet si gjuhë e shkencës dhe teknologjisë pasi që në SHBA ndodhin zbulimet më të mëdha sepse cilësohet si superfuqi që nga viti 1989, prandaj edhe shumica e emërtimeve janë në këtë gjuhë në shumicën për të mos thënë në të gjithë botën.

Në këtë pjesë do t'i përmendim disa anglicizma të emërtimeve teknologjike që përdoren edhe në gjuhën shqipe.

ANGLISHT	HUAZIM	SHQIP
Bit	Bit	Numër binar
Pin	Pin	Numër personal identifikimi
Ram	Ram	Kujtesë
Cd	Cd	Disk kompakt
Pc	Pc	Kompjuter personal
Sms	Sms	Mesazh
E-mail	E-mail	Postë elektronike
Click	Click	Shtyp
Player	Player	Lojtar
File	File	Dosje
Hardware	Hardware	Disk i fortë
Site	Site	Faqe
Power	Power	Forcë
Sensor	Sensor	Ndjesorë
Semiaks	Semiaks	Gjysmëbosht
Header	Heder	Kokë

ANGLICIZMAT NË PORTALE

Sot si mjet i informimit të shpejtë shërbejnë edhe portalet të cila janë në një numër mjft të madh edhe në gjuhë shpeshherë dëshirojnë të duken më në trend dhe më në hap me kohën. Në këtë pjesë do të flasim për disa anglicizma të panvojshme të cilat i kemi hasur në këto portale.

ANGLISHT	HUAZIM	SHQIP

Sponsored	Sponsorët	Mbështetësit
Webpage	Webpage	Faqe interneti
Perfect	Përfekte	Mrekullueshme
Top	Top	Në
Cash	Kesh	Në dorë
Building	Billdingu	Ndërtesë
Nudo	Nudo	Zhveshur
Bodyguard	Bodigard	Truproje
Supervisor	Supervizor	Mbikqyrës
Investigation	Investigoj	Hetoj
Super	Super	I mrekullueshëm
Workshop	Workshop	Seminar
Lider	Lider	Udhëheqës
Train	Trajnoj	Stërvi
Publicity	Publicitet	Reklamë

ANGLISHT	HUAZIM	SHQIP
Curious	Kurioz	Kureshtar
Affirm	Afirmoj	Njoh
Emergent	Emergjencë	Urgjencë
Consensus	Konsensus	Marrëveshje
Discret	Diskret	I matur
Stop	Stopoj	Ndaloj

Event	Event	Ngjarje
Start	Startoj	Filloj
International	Internacional	Ndërkombëtar
Lifestyle	Lifestyle	Mënyrë e jetesës

ANGLICIZMAT NË TË FOLURIN E PËRDITSHËM

Njerëzit komunikojnë çdo ditë për nevojat e tyre jetësore. Zhvillimi i teknologjisë dhe përdorimi i shumtë i rrjeteve sociale kanë ndikuar në përhapjen e anglicizmave edhe në të folurit e përditshëm. Ndonëse kjo tendencë është më e shprehur tek moshat e reja, nuk kanë ‘shpëtuar’ as moshat e tjera nga kjo dukuri (nëse mund të quhet e tillë).

Gjithmonë duhet të kemi parasysh vlerën e gjuhës shqipe dhe ruajtjen e saj nga futja e fjalëve të huaja, sepse futja e fjalëve të huaja rrit rrezikun e zhdukjes së gjuhës në të folurin e përditshëm kohëve të fundit janë përdorur dhe përdoren një numër i madh fjalësh të cilat kanë hyrë nga gjuhët e ndryshme kryesisht sot nga anglishtja sidomos në kohën e pasluftës.

Shumicën e këtyre anglicizmave shqipfolësit i përdorin për t’u treguar mbi të tjerët ose për t’u treguar në hap me

, ‘Njerëz të fushës së letërsisë, apo njohës të gjuhës, akademikë, filozofë etj., mendoj se duhet, që rast pas rasti, të shprehen e ta thonë fjalën e tyre, të tërheqin vëmendjen me mendimet e vjera dhe bindëse. Të mos tregohen të tërhequr duke u justifikuar se jetojmë në kohë “moderne”, t’i përgjigjemi siç e kërkon Shekulli në të cilin jetojmë... e të tjera justifikime’⁹

Në vazhdim do të flasim për disa anglicizma të cilat po përdoren më të madhe në të folurën e përditshëm.

ANGLISHT	HUAZIM	SHQIP
OK	Ok	Në rregull
Thanks	Thanks	Faleminderit
Super	Super	Mrekullueshëm
Like	Like	Pëlqej
Love you	Love you	Të dua
Apply	Aplikoj	Zbatoj
Bravo	Bravo	Të lumtë
Flash	Flash	I shpejtë
Fans	Fansa	Adhures
Horror	Horror	I frikshëm
Live	Live	Drejtëpërdrejt
Perfect	Perfekt	I përsosur
Sensitive	Sensitiv	Indjeshëm
Shopping	Shoping	Blerje
Shoë	Shou	Shfaqje
Shit	Shit	M*t
Monitor	Monitor	Ekran

⁹<https://sot.com.al/opinione/problemet-e-t%C3%AB-folurit-t%C3%AB-p%C3%ABrditsh%C3%ABm-t%C3%AB-gjuh%C3%ABs-shqipe>

Apel	Apeloj	Thirrje
Approve	Aprovoj	Miratoj
Dedicate	Dedikoj	Kushtoj
Experience	Eksperiencë	Përvojë
Quality	Kualitet	Cilësi
Present	Prezent	I pranishëm
Respect	Respektoj	Nderoj
Preference	Preferoj	Pëlqej
Application	Aplikoj	Zbatoj
Support	Suportoj	Mbështes
Illegal	Ilegal	I jashtëligjshëm

PËRFUNDIM

Nga ajo që zhvilluam më lart kuptuam që gjuha shqipe sot është e vërsuar nga anglicizmat sidomos në kohën e pasluftës në Kosovë. Disa fjalë kanë hyrë si pasojë e të mos pasurit së fjalës adekuate në shqipe, ndërsa shumica e tyre kanë hyrë thjeshtë për t'u treguar më të ditur, prandaj detyra e secilit prej nesh është të bëjmë zëvendesimin e këtyre fjalëve të cilat përdoren që në shkolla e deri tek institucionet me të larta, si dhe në të folurin e përditshëm me fjalët gjegjëse të shqipes. Pasi që në këtë rast e ruajmë pastërtinë e gjuhës, dhe e bëjmë pasurimin e saj, shumica e anglicizmave janë fjalë të panevojshmenë gjuhën shqipe, prandaj duhet të kemi kujdes në perdorimin e tyre.

Edhe pse me zhvillimin e teknologjisë në botë dhe rritjes në mënyrë të njejtë edhe të gjuhës angleze dhe ndikimt të sajë në të gjitha gjuhët , përfshirë edhe atë shqipe , do të rritet rreziku i

përdorimit të anglicizmave edhe në vitet në vijmë , mendoj se me punë institucionale , shoqërore dhe individuale do të bëhet ruajtja e gjuhës shqipe dhe përdorimi i fjalëve të duhura e jo në mënyrë të panevojshme i fjalëve nga gjuha angleze dhe jo vetëm.

Gjuha shqipe është mjaft e pasur dhe e bukur me fjalë shqipe prandaj duhet ta respektojmë atë.

“Mund të thuhet se përdorimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhët e popujve të tjetër, është i domosdoshëm. Purizimi që bazohet në parimin e përjashtimit prej gjuhës kombëtare të të gjitha fjalëve të huaja, është i dëmshëm, po ashtu është i dëmshëm edhe përdorimi i tyre, natyrisht në rastet kur nuk janë, vërtetë të domosdoshme. Gjuha, më në fund, i përvetësonë mjaftë lehtë dhe fare natyrshëm dhe i hedh ato që nuk i pergjigjen dhe qe nuk i duhen”¹⁰

LITERATURA

1. <https://www.kohajone.com/2016/07/30/gjuha-shqipe-dhe-historiku-i-saj/>
2. Hamiti, Sabri, “Letersia e vjetër shqipe I”, Albas, Tiranë, 2004.
3. Memushaj, Rami, “Shqipja standarde”, Toena, Tiranë, 2004.
4. Shkurtaç, Gjovalin, “Kultura e gjuhës”, SHBLU, Tiranë, 2006.
5. Qoja, Rexhep, “Nocione të reja albanologjike”, IAP, Prishtinë, 1983.
6. <https://ëëë.zeriamerikes.com/a/alb-historia-gjuha-angleze-113869869/457071.html>
7. https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Historia_e_gjuhes_angleze
8. <https://sot.com.al/opinione/problemet-e-t%C3%AB-folurit-t%C3%AB-p%C3%ABrdits%C3%ABm-t%C3%AB-gjuh%C3%ABs-shqipe>

¹⁰Qosja, Rexhep, “Nocione të reja albanologjike”, IAP, Prishtinë, 1983, fq.70-74

9. <https://sot.com.al/opinione/problemet-e-t%C3%AB-folurit-t%C3%AB-p%C3%ABrditsh%C3%ABm-t%C3%AB-gjuh%C3%ABs-shqipe>
10. Qosja, Rexhep, '*Nocione të reja albanologjike*', IAP, Prishtinë, 1983.